

Nr. 972 Dt. 27.09.2023

Shkolla e Mesme Profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina" dhe "Minatori" Fushë Kosovë

Në bazë të UA nr.02/2016 të datës 12.01.2016 të MASHT-it, Dreitoria e Shkollës së Mesme Profesionale në Fushë Kosovë mori vendim të shpallë:

## FTESË-OFERTË

### Për realizimin e ekskursionit të maturantëve të Shkollës Profesionale - Fushë Kosovë

Ftohen Agjencite Turisitike që të marrin pjesë në transportimin dhe akomodimin e 150 maturantëve të Shkollës së Mesme Profesionale në Fushë Kosovë në Republikën e Shqipërisë në kohë zgjatje prej pesë ditëve e katër bujtjeve.

Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit, transportit dhe shpenzime të ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave.

Agjencioni për ekskursion duhet të plotësoj këto kushte:

1. Operatori ekonomik duhet të ketë licencën sipas ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit - ofertës t'i bashkangjiten fotokopjet e këtyre dokumentave (të verifikuara te noteri),
2. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve dhe në pronësi të veten,
3. Autobusët të kenë kontrollimin teknik sipas procedurave ligjore me certifikata të lëshuara nga Ministria,
4. Autobusët duhet të jenë komfort dhe me klimë,
5. Agjencioni duhet të sigurojë mjekun (çertifikatë pune dhe diplomë të mjekut),
6. Preferohet sigurimi i hotelit nga Agjencioni,
7. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i hotelit)
8. Të i përmbahet itinerarit të realizimit të ekskursionit, i përpiluar nga Këshilli Drejtues i Shkollës,
9. Ekskursioni planifikohet të realizohet prej datës 09.10.2023 deri më datën 13.10.2023.
10. Dokumentet e pakompletura nuk shqyrtohen.

Konkursi është i hapur 7 ditë kalendarike, prej ditës së shpalljes në web faqen zyrtare të komunës.

Oferta mbetet e hapur deri me datën 03.10.2023 në ora 14:00.

Dokumentet e kompletura dorëzohen te Sekretari i Shkollës Profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina" në Fushë Kosovë.

Hapja e ofertave bëhet me datën 03.10.2023 në ora 14:00 nga komisioni, pa praninë e operatorëve. Fituesi i ofertës do të njoftohet përmes telefonit ose e-mailit si dhe do të publikohet në web faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës.

Fushë Kosovë : 27.10.2023



Zv.drejtor: Ukshin Uka

Zv.drejtor: Rexhep Berisha